

رسالتان موجزتان في الزكاة والصيام

**DY BROSHURA TË SHKURTRA
NË LIDHJE ME ZEKATIN DHE
AGJËRIMIN**

DY BROSHURA TË SHKURTRA NË LIDHJE ME ZEKATIN DHE AGJËRIMIN

Abdulaziz ibën Abdullah ibën Baz

DY BROSHURA TË SHKURTRA NË LIDHJE ME ZEKATIN DHE AGJËRIMIN

nga hoxha i nderuar

Abdulaziz ibën Abdullah ibën Baz

Allahu e pastë mëshiruar!

Broshura e parë:

HULUMTIME TË RËNDËSISHME QË KANË TË BËJNË ME ZEKATIN

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit!

Çdo lavdërim i takon vetëm Allahut, ndërsa
salavatet dhe selamet qofshin për atë, pas të cilit
nuk ka profet tjetër, si dhe për familjen dhe shokët
e tij.

Ajo që më shtyu t'i shkruaj këto fjalë është
këshilla dhe përkujtimi për detyrën e zekatit, të
cilin e kanë neglizhuar shumë muslimanë, duke
mos e dhënë në mënyrën e duhur, pavarësisht
rëndësisë së tij të madhe dhe faktit se ai është një
nga pesë shtyllat e Islamit, pa të cilat ndërtesa e tij
nuk qëndron; bazuar në fjalën e Pejgamberit (paqja
qoftë mbi të!):

«بُنِيَ الْإِسْلَامُ عَلَى خَمْسٍ: شَهَادَةِ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ، وَإِقَامِ
الصَّلَاةِ، وَإِيتَاءِ الزَّكَاةِ، وَصَوْمِ رَمَضَانَ، وَحَجِّ الْبَيْتِ»،

"Islami është ngritur mbi pesë shtylla: Dëshmia se nuk ka të adhuruar përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe kryerja e haxhit."¹ Unanimisht i saktë.

Ngarkimi i muslimanëve me detyrën e zekatit është një nga virtytet më evidente të Islamit që dëshmon për kujdesin e Islamit ndaj përfaqësuesve të vet. Pasi dobitë e zekatit janë të shumta dhe nevoja e muslimanëve të varfër për të është e madhe.

Disa nga dobitë e zekatit janë:

-Forcimi i lidhjeve vëllazërore ndërmjet të pasurit dhe të varfrit, sepse për nga natyra, njeriu e don atë që i bën mirë.

-Pastrimi i shpirtit dhe dëlirësimi i tij nga cilësia e egoizmit dhe koprracisë, siç e ka theksuar Kurani Famëlartë:

﴿خُذْ مِنْ أَمْوَالِهِمْ صَدَقَةً تُطَهِّرُهُمْ وَتُزَكِّيهِمْ بِهَا...﴾

"Merr nga pasuria e tyre lëmoshë me të cilën t'i pastrosh dhe t'i dëlirësosh ata!" (Et-Teube, 103)

-Edukimi i muslimanit me virtytin e bujarisë, fisnikërisë dhe dhembshurisë ndaj nevojtarit.

-Ndjellja dhe tërheqja e bereqetit, shtimit të rrizkut dhe kompensimit të pasurisë, në rast fatkeqësie, siç thotë i Madhërishmi:

¹ Transmetuan Buhariu nr. 8 dhe Muslimi nr. 16.

﴿...وَمَا أَنْفَقْتُمْ مِنْ شَيْءٍ فَهُوَ يُخْلِفُهُ وَهُوَ خَيْرُ الرَّازِقِينَ﴾

"Çfarëdo që të shpenzoni, Ai ua kompenson, Ai është Furnizuesi më i mirë." (Sebe, 39) Dhe siç ka thënë Profeti (paqja qoftë mbi të!) në hadithin autentik: "Allahu thotë:

«يَا ابْنَ آدَمَ أَنْفِقْ نُنْفِقْ عَلَيْكَ...»،

'O bir i Ademit! Jep, të të jepet!...'”¹ Si dhe dobi të tjera të shumta.

Ndërkohë, në tekstet fetare theksohet kërcënim i ashpër për ata që tregohen koprracë ose neglizhentë në dhënien e zekatit. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿...وَالَّذِينَ يَكْنِزُونَ الذَّهَبَ وَالْفِضَّةَ وَلَا يُنْفِقُونَهَا فِي سَبِيلِ اللَّهِ فَبَشِّرْهُمْ بِعَذَابٍ أَلِيمٍ 34 يَوْمَ يُحْمَىٰ عَلَيْهَا فِي نَارِ جَهَنَّمَ فَتُكْوَىٰ بِهَا جِبَاهُهُمْ وَجُنُوبُهُمْ وَظُهُورُهُمْ هَٰذَا مَا كُنَزْتُمْ لَأَنْفُسِكُمْ فَذُوقُوا مَا كُنْتُمْ تَكْنِزُونَ﴾ 35

"Ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk e shpenzojnë në rrugën e Allahut, paralajmëroji me dënim të dhembshëm.

Ditën, kur (thesaret e mbledhura) do të digjen në zjarrin e Xhehenemit dhe me to do të damkoset balli, brinjët dhe shpina e tyre e do t'u thuhet: 'Kjo është ajo që keni grumbulluar për veten; pra, shijoni atë që grumbulluat!'" (Et-Teube, 34-35) Pra, çdo pasuri nga e cila nuk nxirret zekati, është thesar për shkak të cilit do të dënohet pronari i tij në Ditën

¹ Transmetoi Muslimi nr. 993.

e Kiametit. Për këtë dëshmon dhe hadithi i saktë nga Profeti (paqja qoftë mbi të!) se ka thënë:

«مَا مِنْ صَاحِبٍ ذَهَبٍ وَلَا فِصَّةٍ لَا يُؤَدِّي حَقَّهَا إِلَّا إِذَا كَانَ يَوْمَ الْقِيَامَةِ صُفِّحَتْ لَهُ صَفَائِحُ مِنْ نَارٍ؛ فَأُحْمِيَ عَلَيْهَا فِي نَارِ جَهَنَّمَ، فَيَكْوَى بِهَا جَنْبُهُ وَجَبِينُهُ وَظَهْرُهُ كُلَّمَا بَرَدَتْ أُعِيدَتْ لَهُ فِي يَوْمٍ كَانَ مِقْدَارُهُ خَمْسِينَ أَلْفَ سَنَةٍ حَتَّى يُفْضَى بَيْنَ الْعِبَادِ، فَيُرَى سَبِيلُهُ: إِمَّا إِلَى الْجَنَّةِ، وَإِمَّا إِلَى النَّارِ».

“Ai pronar i arit dhe argjendit, që nuk e jep hakun e tyre (zekatin), kur të bëhet Dita e Kiametit ato do t'i shndërrohen në pllaka prej Zjarri, të cilat do të skuqen në zjarr të Xhehenemit e me to do t'i hekuroset trupi, balli e shpina. Sa herë që ftohen, do të skuqen sërish në zjarr, në ditën, gjatësia e së cilës është pesëdhjetë mijë vjet. Kur të mbarojë gjykimi mes njerëzve, atij do t'i tregohet rruga: ose për në Xhenet, ose për në Zjarr.”¹

Më pas Profeti (paqja qoftë mbi të!) përmendi edhe pronarin e deveve, lopëve dhe deleve, i cili nuk e jep zekatin e tyre, dhe lajmëroi se ai do të ndëshkohet nëpërmjet tyre në Ditën e Kiametit.

Është vërtetuar gjithashtu nga i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) se ka thënë:

«مَنْ آتَاهُ اللَّهُ مَالًا فَلَمْ يُؤَدِّ زَكَاةَ مِثْلَ لَهُ شُجَاعًا أَفْرَعَهُ لَهُ رَبِّبَتَانِ يُطَوِّفُهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ، ثُمَّ يَأْخُذُ بِلَهْزِ مَنْتَاهِ (يَعْنِي سِدْقِيهِ)، ثُمَّ يَقُولُ: أَنَا مَالِكٌ، أَنَا كُنْزُكَ»، ثُمَّ تَلَا النَّبِيُّ ﷺ قَوْلَهُ تَعَالَى: (وَلَا يَحْسِنَنَّ الَّذِينَ يَبْخُلُونَ بِمَا ءَاتَاهُمُ اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ هُوَ خَيْرٌ لَّهُمْ بَلْ هُوَ شَرٌّ لَّهُمْ سَيُطَوَّقُونَ مَا بَخُلُوا بِهِ يَوْمَ الْقِيَامَةِ...)

"Kujt i ka dhënë Allahu pasuri dhe ai nuk e jep zekatin e saj, Ditën e Kiametit ajo do t'i shfaqet në

¹ Transmetoi Muslimi nr. 987.

formën e një gjarpri pa qime në kokë, me dy pika të zeza mbi sy. Ai do t'i mbështillet në qafë, do ta kapë për nofullash dhe do t'i thotë: 'Unë jam pasuria jote, unë jam thesari yt.' Më pas, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) lexoi fjalën e Allahut të Lartësuar: 'Ata që bëhen koprracë me të mirat që ua ka dhënë Allahu, kurrresi të mos mendojnë se kështu është më mirë për ta! Jo, kjo është më keq për ta! Ajo që kanë grumbulluar do t'u mbështillet atyre në qafë Ditën e Kiametit...' (Ali Imran, 180)¹

Zekati është obligim në katër lloje pasurish: prodhimet e tokës, si drithërat dhe frutat, bagëtitë që kullosin në natyrë, ari dhe argjendi, dhe mallrat tregtare.

Secila prej këtyre katër kategorive ka një nisab (sasi) të caktuar, dhe nuk është i detyrueshëm zekati në sasi më të vogël se ai. Nisabi i drithërave dhe i frutave është pesë uesekë – ku një uesek është i barabartë me gjashtëdhjetë saë sipas sait që përdorej në kohën e Profetit (paqja qoftë mbi të!). Për hurmat, rrushin e thatë, grurin, orizin, elbin e të ngjashme me to, nisabi është treqind saë, sipas sait që përdorej në kohën e Profetit (paqja qoftë mbi të!), ku një saë është i barabartë me katër grushta të mbushur plot të një burri me trup mesatar.

Sasia e detyrueshme që duhet të nxirret nga këto është dhjetë përqindëshi, kur palmat dhe të

¹ Shënon Buhariu, nr. 1338.

mbjellat ujiten pa shpenzime, si për shembull, kur ujiten me ujin e shirave, ujin e lumenjve, ujin e burimeve rrjedhëse etj.

Kurse, nëse vaditen me shpenzime dhe me mund njerëzor, si për shembull, me rrotë apo me pompa uji etj, atëherë duhet dhënë pesë përqindëshi i prodhimit, siç ceket në hadithin e saktë të të Dërguarit të Allahut (paqja qoftë mbi të!).

Sa i përket nisabit të deveve, lopëve dhe dhenve, lidhur me të ka sqarime të hollësishme në hadithet e sakta të Profetit të Allahut (paqja qoftë mbi të!). Ai që dëshiron t'i dijë, mund të pyesë të diturit. Sikur të mos ishte për hir të shkurtimit, do t'i kishim përmendur në mënyrë që lexuesi të përfitonte sa më shumë.

Kurse nisabi i argjendit është njëqind e dyzet mithkalë, që është baras me pesëdhjetë e gjashtë rijalë saudit.

Nisabi i floririt është njëzet mithkalë, që është baras me njëmbëdhjetë xhunejhë e tre të shtatat e xhunejhut saudit, ndërsa në gramë është nëntëdhjetë e dy gramë; sasia e zekatit që duhet dhënë është çereku i një të dhjetës për atë që e ka në pronësi nisabin e tyre ose të njërit prej tyre, pasi të ketë kaluar viti.

Çdo përqindje që shtohet më pas i bashkangjitet pasurisë bazë, prandaj nuk ka nevojë që të kalojë një vit tjetër për të, ashtu si pjella e bagëtive që i bashkangjitet bagëtive bazë, prandaj nuk kanë

nevojë të kalojë një vit i ri nëse bagëtitë bazë e kanë plotësuar nisabin.

Të njëjtin gjykim si ari dhe argjendi kanë edhe paratë prej letre (kartëmonedhat) me të cilat njerëzit bashkëveprojnë sot, pavarësisht nëse quhen dirhem, dinar, dollar apo me emra të tjerë. Nëse vlera e tyre e arrin nisabin e argjendit ose të arit dhe ka kaluar një vit, atëherë dhënia e zekatit bëhet e detyrueshme.

Arit dhe argjendit i bashkëngjiten edhe stolitë e grave prej ari apo argjendi, kur ato arrijnë nisabin dhe kalon një vit i plotë hënor. Zekati është i detyrueshëm në to, edhe nëse janë të destinuara për përdorim apo për huazim, sipas mendimit më të saktë të dijetarëve, për shkak të përgjithëshmërisë së fjalës së Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!):

«مَا مِنْ صَاحِبِ ذَهَبٍ أَوْ فِضَّةٍ لَا يُؤَدِّي زَكَاتَهَا إِلَّا إِذَا كَانَ يَوْمُ الْقِيَامَةِ صُفِحَتْ لَهُ صَفَائِحُ مِنْ نَارٍ».

“Ai pronar i arit apo argjendit, që nuk e jep zekatin e tyre, kur të bëhet Dita e Kiametit, do t'i shndërrohen në pllaka prej Zjarri.” (5)¹ Hadithi i plotë është cituar më lart.

Dhe për shkak të hadithit të saktë që është transmetuar nga Profeti (paqja qoftë mbi të!) se ai pa në dorën e një gruaje dy byzylykë ari dhe tha:

¹ Transmetoi Muslimi nr. 987.

«أَعْطِينِ زَكَاةَ هَذَا؟». قَالَتْ: لَا. قَالَ: «أَيْسُرُكَ أَنْ يُسَوِّرَكَ اللَّهُ بِهِمَا يَوْمَ الْقِيَامَةِ سِوَارَيْنِ مِنْ نَارٍ!». فَأَلْقَتْهُمَا، وَقَالَتْ: «هُمَا لِلَّهِ وَلِرَسُولِهِ».

“A e jep zekatin e këtyre?” Ajo tha: “Jo.” Ai i tha: “A do të pëlqente që Allahu, Ditën e Kiametit, të të vendoste në vend të tyre dy byzylykë prej zjarri?!” Ajo i hoqi dhe tha: “Këto janë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij.”¹

Është vërtetuar nga Umu Seleme (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se ajo kishte veshur stoli prej ari dhe e pyeti Pejgamberin: "O i Dërguari i Allahut, a konsiderohen thesar (kursime) këto?" Ai i tha:

«مَا بَلَغَ أَنْ يُزَكَّى فَرُكِّي فَلَيْسَ بِكُنْزٍ»

“Ajo pasuri që arrin sasinë e zekatit dhe prej saj nxirret zekati, nuk konsiderohet thesar (kursime).” (7)² Si dhe bazuar dhe në hadithe të tjera që përcillen në këtë kontekst.

Ndërsa mallrat tregtare, pra mallrat e destinuara për shitje, vlerësohen në fund të vitit dhe prej tyre jepet çereku i një të dhjetës së vlerës që kanë, pavarësisht nëse kjo vlerë është sa çmimi i blerjes, më e lartë apo më e ulët; bazuar në hadithin e Semures (Allahu qoftë i kënaqur me të!) i cili ka thënë:

«كَانَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ يَأْمُرُنَا أَنْ نُخْرِجَ الصَّدَقَةَ مِنَ الَّذِي نُعِدُّهُ لِلْبَيْعِ».

¹ E transmetuan Ebu Davudi, nr. 1563 dhe Nesaiu, nr. 2270, me varg të mirë të transmetimit.

² Transmetoi Ebu Davudi nr. 1564.

“I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) na urdhëronte të jepnim sadaka (zekat) nga malli që e kishim për shitje.”¹

Këtu përfshihen tokat e destinuara për shitje, ndërtesat, automjetet, pompat e ujit e lloje të tjera mallrash të destinuara për shitje.

Sa u përket ndërtesave që mbahen për qiradhënie e jo për shitje, zekati jepet për vlerën e qirasë së fituar nga ato, kur plotësohet viti. Kurse për vetë ato nuk ka zekat, meqenëse nuk mbahen për shitje. Po kështu, për veturat private dhe taksitë, nuk jepet zekat nëse nuk janë për shitje dhe pronari i tyre i ka blerë për përdorim vetjak.

Nëse pronarit të taksisë, apo kujtdo tjetër, i mbliidhen të holla që e arrijnë nisabin, ai e ka obligim të japë zekatin për to pasi të kalojë një vit, pavarësisht nëse i ka ndarë për shpenzime, për martesë, për të blerë ndonjë pronë të patundshme, për të larë ndonjë borxh apo për qëllime të tjera; kjo, për shkak të argumenteve të përgjithshme fetare që tregojnë se zekati në raste të tilla është obligim.

Mendimi më i saktë i dijetarëve është se borxhi nuk e pengon zekatin, bazuar në argumentet që u përmendën më parë.

Po kështu, për pasurinë e jetimëve dhe të paaftëve mentalisht është obligim të jepet zekati,

¹ Transmetoi Ebu Davudi nr. 1562.

sipas shumicës së dijetarëve, nëse ajo e arrin sasinë e caktuar (nisabin) dhe ka kaluar një vit. Kujdestarët e tyre e kanë obligim ta japin zekatin në emër të tyre kur të plotësohet viti, bazuar në argumentet e përgjithshme, si thënia e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!) në hadithin e Muadhit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), kur e dërgoi te banorët e Jemenit:

«إِنَّ اللَّهَ افْتَرَضَ عَلَيْهِمْ صَدَقَةً فِي أَمْوَالِهِمْ تُؤْخَذُ مِنْ أَغْنِيَائِهِمْ، وَتُرَدُّ فِي فُقَرَائِهِمْ».

"Vërtet, Allahu ua ka bërë detyrim një lëmoshë në pasuritë e tyre, që merret prej të pasurve të tyre dhe u jepet të varfërve të tyre."¹

Zekati është e drejta e Zotit dhe nuk lejohet t'u jepet atyre që nuk e meritojnë, as që njeriu të përfitojë prej tij apo t'i bëjë bisht, dhe as që me të, të mbrojë pasurinë e tij apo të shmangë kritikën. Përkundrazi, muslimani duhet t'ua japë zekatin e tij atyre që e meritojnë, për vetë faktin se atyre u takon, e jo për ndonjë qëllim tjetër, duke e bërë këtë me plot zemër dhe me sinqeritet vetëm për Zotin e tij, në mënyrë që të lirohet nga përgjegjësia dhe të meritojë shpërblimin e madh dhe kompensimin që i premtohet.

Allahu i Lartësuar i ka shpjeguar në Librin e Tij kategoritë e njerëzve të cilëve u jepet zekati. Ai ka thënë:

¹ Transmetuan Buhariu nr. 1395 dhe Muslimi nr. 19.

﴿إِنَّمَا الصَّدَقَتُ لِلْفُقَرَاءِ وَالْمَسْكِينِ وَالْعَمِلِينَ عَلَيْهَا وَالْمُؤَلَّفَةِ قُلُوبُهُمْ وَفِي الرِّقَابِ
وَالْغُرَمِينَ وَفِي سَبِيلِ اللَّهِ وَأَبْنِ السَّبِيلِ فَرِيضَةً مِّنَ اللَّهِ وَاللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ 60﴾

"Lëmosha e zekatit është vetëm për të varfrit, për nevojtarët, për ata që janë ngarkuar me mbledhjen dhe administrimin e tij, për ata të cilëve u duhet fituar zemra (në Islam), për lirimin e skllevërve, për të rënduarit nga borxhet, për (luftëtarët në) rrugën e Allahut dhe për udhëtarët e mbetur rrugëve. Kjo është detyrë e caktuar prej Allahut. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë." (Et-Teube, 60)

Në mbylljen e këtij ajeti fisnik me këta dy emra madhështorë ka një përkujtim të rëndësishëm nga ana e Allahut të Lartësuar për robërit e Vet; se Ai, i Lartësuari, është i Gjithëdijshtëm lidhur me gjendjet e robërve të Vet; kush prej tyre e meriton lëmoshën dhe kush nuk e meriton, dhe se Ai vepron me urtësi të plotë në legjislacionin dhe kaderin Tij. Prandaj, Ai nuk i vendos gjërat veçse në vendin e tyre të përshtatshëm, edhe pse disa njerëz nuk mund t'i dijnë disa prej sekreteve të urtësisë së Tij. Kësisoj, robërit gjejnë qetësi në legjislacionin e Tij dhe i dorëzohen gjykimit të Tij.

Allahut i lutemi të na japë sukses neve dhe gjithë muslimanëve në kuptimin e fesë së Tij, në sinqeritetin në marrëdhënie me Të, në garën drejt asaj që e kënaq Atë, dhe në shpëtimin nga shkaqet e zemërimit të Tij. Padyshim Ai është Dëgjues dhe i Afërt.

Salavatet dhe selamet qofshin për robin dhe të Dërguarin e Tij, Muhamedin, familjen dhe shokët e tij.

Kryetari i Përgjithshëm i Drejtorive të Studimeve Shkencore,

Fetvadhënies, Propagandës dhe Orientimit.

Hoxha i nderuar, Abdulaziz ibën Abdullah ibën Bazi

Broshura e dytë:

VLERA E AGJËRIMIT TË RAMAZANIT DHE NAMAZIT TË NATËS, ME SQARIMIN E DISPOZITAVE TË RËNDËSISHME QË MUND TË JENË TË PANJOHURA PËR DISA NJERËZ

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Nga Abdulaziz ibën Abdullah ibën Bazi, drejtuar gjithë muslimanëve që e lexojnë këtë broshurë, Allahu më drejtoftë mua dhe ata në rrugën e besimtarëve dhe më dhëntë sukses mua dhe atyre për të kuptuar Sunetin dhe Kuranin. Amin!

Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ju!

Kjo është një këshillë e shkurtër lidhur me vlerën e agjërimit të Ramazanit dhe faljes në netët e tij, si dhe vlerës së garimit për vepra të mira gjatë tij, bashkë me sqarimin e disa dispozitave të rëndësishme që mund të jenë të panjohura për disa njerëz.

Është vërtetuar nga i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) se ai i përgëzonte shokët e tij me ardhjen e muajit Ramazan, dhe i njoftonte se është një muaj ku hapen dyert e mëshirës dhe portat e Xhenetit, mbyllen dyert e Xhehenemit dhe prangosen shejtanët, dhe thoshte:

«إِذَا كَانَتْ أَوَّلُ لَيْلَةٍ مِنْ رَمَضَانَ فَتُحْتَفَلُ أَبْوَابُ الْجَنَّةِ فَلَمْ يُغْلَقْ مِنْهَا بَابٌ، وَغُلِقَتْ أَبْوَابُ جَهَنَّمَ فَلَمْ يُفْتَحْ مِنْهَا بَابٌ، وَصُودَّتِ الشَّيَاطِينُ، وَيُنَادِي مُنَادٍ: يَا بَاغِيَ الْخَيْرِ أَقْبِلْ، وَيَا بَاغِيَ الشَّرِّ أَقْصِرْ. وَلِلَّهِ عِتْقَاءُ مِنَ النَّارِ، وَذَلِكَ كُلُّ لَيْلَةٍ».

"Në natën e parë të Ramazanit hapen dyert e Xhenetit dhe asnjëra prej tyre nuk mbyllet, mbyllen dyert e Xhehenemit dhe asnjëra prej tyre nuk hapet, dhe prangosen shejtanët. Dhe një thirrës thërret: 'O ti që kërkon të mirën, afrohu, dhe o ti që kërkon të keqen, ndalu!' Dhe në çdo natë Allahu liron njerëz nga zjarri"

Po ashtu, ai (paqja qoftë mbi të!) thoshte:

«جَاءَكُمْ شَهْرُ رَمَضَانَ شَهْرُ بَرَكَاتٍ يَغْشَاكُمْ اللَّهُ فِيهِ: فَيَنْزِلُ الرَّحْمَةُ وَيَحُطُّ الْخَطَايَا، وَيَسْتَجِيبُ الدُّعَاءَ، يَنْظُرُ اللَّهُ إِلَى تَنَافُسِكُمْ فِيهِ فَيَبَاهِي بِكُمْ مَلَائِكَتُهُ؛ فَأَرَوْا اللَّهَ مِنْ أَنْفُسِكُمْ خَيْرًا؛ فَإِنَّ السَّقْيَ مِنْ حُرْمٍ فِيهِ رَحْمَةُ اللَّهِ».

"Ju ka ardhur muaji i Ramazanit, muaji në të cilin Allahu lëshon begati mbi ju. Ai lëshon mëshirë, shlyen mëkatet dhe i përgjigjet lutjes. Allahu shikon garimin tuaj në të dhe krenohet me ju para engjëjve të Tij; andaj, tregoni Allahut më të mirën nga vetja juaj, sepse i pafat është ai që privohet në këtë muaj nga mëshira e Allahut!"

Po ashtu, ai (paqja qoftë mbi të!) thoshte:

«مَنْ صَامَ رَمَضَانَ إِيمَانًا وَاحْتِسَابًا غُفِرَ لَهُ مَا تَقَدَّمَ مِنْ ذَنْبِهِ، وَمَنْ قَامَ رَمَضَانَ إِيمَانًا وَاحْتِسَابًا غُفِرَ لَهُ مَا تَقَدَّمَ مِنْ ذَنْبِهِ، وَمَنْ قَامَ لَيْلَةَ الْقَدْرِ إِيمَانًا وَاحْتِسَابًا غُفِرَ لَهُ مَا تَقَدَّمَ مِنْ ذَنْبِهِ».

"Atij që agjëron Ramazanin duke besuar dhe shpresuar në shpërblimin e Allahut, i falen mëkatet e së kaluarës, dhe atij që falet në Ramazan duke besuar dhe shpresuar në shpërblimin e Allahut, i falen mëkatet e së kaluarës, dhe atij që falet Natën e Kadrit duke besuar dhe shpresuar në shpërblimin e Allahut, i falen mëkatet e së kaluarës."

Po ashtu, thoshte:

«يَقُولُ اللَّهُ: كُلُّ عَمَلٍ ابْنِ آدَمَ لَهُ الْحَسَنَةُ بِعَشْرِ أَمْثَالِهَا إِلَى سَبْعِمِائَةِ ضِعْفٍ إِلَّا الصِّيَامَ فَإِنَّهُ لِي وَأَنَا أَجْزِي بِهِ؛ تَرَكَ شَهْوَتَهُ وَطَعَامَهُ وَشَرَابَهُ مِنْ أَجْلِي. لِلصَّائِمِ فَرْحَتَانِ: فَرْحَةٌ عِنْدَ فِطْرِهِ، وَفَرْحَةٌ عِنْدَ لِقَاءِ رَبِّهِ. وَلَخُلُوفُ فَمِ الصَّائِمِ أَطْيَبُ عِنْدَ اللَّهِ مِنْ رِيحِ الْمِسْكِ».

"Allahu thotë: 'Çdo vepër e birit të Ademit i shumëfishohet: një e mirë shpërblehet dhjetëfish deri në shtatëqindfish, përveç agjërit, i cili është për Mua dhe Unë shpërblej për të; ai e lë epshin, ushqimin dhe pijen për Mua. Agjëruesi ka dy gëzime: një gëzim kur bën iftar dhe një gëzim kur takon Zotin e tij. Dhe era e gojës së agjëruetit është më e mirë tek Allahu sesa era e myshkut."

Hadithet për vlerën e agjërit të ramazanit dhe namazit të natës gjatë tij, si dhe për vlerën e agjërit në përgjithësi, janë të shumta.

Prandaj, besimtari duhet ta shfrytëzojë këtë mundësi, që Allahu ia ka dhuruar duke i mundësuar arritjen e muajit Ramazan; të nxitojë drejt veprave

të mira, të ruhet nga gjynahet dhe të bëjë përpjekje për kryerjen e asaj që Allahu ia ka bërë obligim, e veçanërisht për pesë namazet, pasi ato janë shtylla e Islamit dhe janë obligimet më madhështore pas shehadetit. Prandaj, është detyrë për çdo musliman dhe muslimane të kujdeset ndaj tyre dhe ta kryejë faljen e tyre në kohët e veta me përpjekje dhe qetësi.

Prej detyrave më të rëndësishme për burrat është falja e namazit me xhemat në shtëpitë e Allahut, për të cilat Allahu ka lejuar që të lartësohen dhe të përmendet në to emri i Tij. Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿وَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَآتُوا الزَّكَاةَ وَارْكَعُوا مَعَ الرَّاكِعِينَ﴾ (43)

"Faleni namazin, jepeni zekatin dhe përkuluni në ruku bashkë me ata që përkulen!" (El-Bekare, 43) Gjithashtu Allahu i Lartësuar thotë:

﴿حُفِظُوا عَلَى الصَّلَوَاتِ وَالصَّلَاةِ الْاَوْسَطَىٰ وَفُؤُوا لِلَّهِ فَنِينَ﴾ (238)

"Faleni rregullisht namazin, sidomos atë të mesmin dhe qëndroni me devotshmëri para Allahut, duke iu lutur Atij!" (El-Bekare, 238) Ai ka thënë gjithashtu:

﴿قَدْ أَفْلَحَ الْمُؤْمِنُونَ 1 الَّذِينَ هُمْ فِي صَلَاتِهِمْ خَاشِعُونَ 2﴾

"Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përpjekur në namazin e tyre." [El-Mu'minunë: 1-2] Deri tek fjala e Tij:

﴿وَالَّذِينَ هُمْ عَلَى صَلَاتِهِمْ يُحَافِظُونَ 9 أُولَٰئِكَ هُمُ الْوَارِثُونَ 10 الَّذِينَ يَرْتُونَ 11﴾
﴿الْفِرْدَوْسَ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ﴾ (11)

"Dhe të cilët i kryejnë rregullisht faljet. Ata janë trashëgimtarët, të cilët do të trashëgojnë Firdeusin, ku do të jenë përgjithmonë." (El-Mu'minunë, 9-11) Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«الْعَهْدُ الَّذِي بَيْنَنَا وَبَيْنَهُمُ الصَّلَاةُ فَمَنْ تَرَكَهَا فَقَدْ كَفَرَ».

"Besëlidhja ndërmjet nesh dhe atyre (jobesimtarëve) është namazi. Andaj, ai që e lë namazin, ka bërë kufër (mosbesim)."

Pas namazit, obligimi më i rëndësishëm është dhënia e zekatit, sikurse ka thënë Allahu i Madhëruar:

﴿وَمَا أَمْرُو إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ حُنَفَاءَ وَيُقِيمُوا الصَّلَاةَ وَيُؤْتُوا الزَّكَاةَ وَذَلِكَ دِينُ الْقَيِّمَةِ 5﴾

"E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të singertë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin e të jepnin zekatin. Kjo është feja e drejtë." (El-Bejineh, 5) Gjithashtu Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَآتُوا الزَّكَاةَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ 56﴾

"Falni namazin, jepni zekatin dhe bindjuni të Dërguarit, për të fituar mëshirën e Allahut!" (En-Nur, 56)

Libri i Madhërishëm i Allahut dhe Suneti i të Dërguarit të Tij fisnik tregojnë se kushdo që nuk e jep zekatin e pasurisë së tij, do të dënohet nëpërmjet saj në Ditën e Kiametit.

Dhe çështja më e rëndësishme pas namazit dhe zekatit është agjërimi i Ramazanit, i cili është një nga pesë shtyllat e Islamit, të përmendura në thënien e Profetit (paqja qoftë mbi të!):

«بُنِيَ الْإِسْلَامُ عَلَى خَمْسٍ: شَهَادَةِ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ، وَإِقَامِ الصَّلَاةِ، وَإِيتَاءِ الزَّكَاةِ، وَصَوْمِ رَمَضَانَ، وَحَجِّ الْبَيْتِ».

"Islami është ngritur mbi pesë shtylla: Dëshmia se nuk ka të adhuruar përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe kryerja e haxhit."

Muslimani e ka për detyrë të ruajë agjërimin dhe namazin e tij nga fjalët dhe veprat që Allahu ia ka ndaluar; sepse qëllimi i agjëritit është bindja ndaj Allahut të Lartësuar, madhërimi i shenjtërive të Tij, lufta me veten kundra egos në shenjë bindjeje ndaj Zotit, dhe mësimi i vetes me durim ndaj asaj që Allahu e ka ndaluar. Pra, qëllimi nuk është thjesht lënia e ushqimit, pijes dhe gjërave të tjera që e prishin agjërimin. Prandaj, është vërtetuar se i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«الصَّيَّامُ جُنَّةٌ، فَإِذَا كَانَ يَوْمُ صَوْمِ أَحَدِكُمْ فَلَا يَرْفُثْ وَلَا يَصْحَبْ، فَإِنْ سَاءَ أَحَدٌ أَوْ قَاتَلَهُ فَلْيَقُلْ: إِنِّي صَائِمٌ».

"Agjërimi është mburojë, andaj, ditën që dikush agjëron, të mos thotë fjalë të ndyta e as të mos bërtasë. Nëse dikush e shan ose e sulmon, le të thotë: 'Unë jam agjërueshëm!' Po ashtu, është

vërtetuar nga Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) se ka thënë:

«مَنْ لَمْ يَدَعْ قَوْلَ الزُّورِ وَالْعَمَلَ بِهِ وَالْجَهْلَ فَلَيْسَ لِلَّهِ حَاجَةٌ فِي أَنْ يَدَعَ طَعَامَهُ وَشَرَابَهُ».

"Ai që nuk e lë fjalën e rreme, të vepruarit sipas saj dhe sjelljen e keqe, Allahu nuk ka nevojë që ai të lërë ushqimin dhe pijen e tij!" Nga këto tekste dhe të tjera kuptohet se agjëruesi e ka për detyrë të ruhet nga gjithçka që Allahu e ka ndaluar dhe t'i përmbahet me përkushtim gjithçkaje që Allahu e ka bërë obligim. Vetëm kështu, mund të ketë shpresë për faljen e gjynaheve, shpëtimin nga Zjarri dhe pranimin e agjërimit e të namazit të natës.

Ekzistojnë edhe disa çështje, të cilat disa njerëz mund të mos i dinë:

Njëra prej tyre është se muslimani e ka për obligim të agjërojë duke besuar dhe duke shpresuar në shpërblimin që i premtohet, e jo për syfaqësi e as famë, as për të imituar njerëzit apo për të ndjekur familjen ose banorët e vendit të tij. Përkundrazi, duhet që shtysa e tij për agjërim të jetë besimi se Allahu ia ka bërë atë obligim dhe shpresa për shpërblimin që Ai i premton. Po kështu edhe namazin e natës në Ramazan, muslimani duhet ta falë duke besuar dhe duke shpresuar në shpërblimin që i premtohet, e jo për ndonjë arsye tjetër; prandaj Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

«مَنْ صَامَ رَمَضَانَ إِيمَانًا وَاحْتِسَابًا غُفِرَ لَهُ مَا تَقَدَّمَ مِنْ ذَنْبِهِ، وَمَنْ قَامَ رَمَضَانَ إِيمَانًا وَاحْتِسَابًا غُفِرَ لَهُ مَا تَقَدَّمَ مِنْ ذَنْبِهِ، وَمَنْ قَامَ لَيْلَةَ الْقَدْرِ إِيمَانًا وَاحْتِسَابًا غُفِرَ لَهُ مَا تَقَدَّمَ مِنْ ذَنْبِهِ».

"Atij që agjëron Ramazanin, duke besuar dhe shpresuar në shpërblimin e Allahut, i falen mëkatet e së kaluarës, dhe atij që falet në Ramazan, duke besuar dhe shpresuar në shpërblimin e Allahut, i falen mëkatet e së kaluarës, dhe atij që falet Natën e Kadrit, duke besuar dhe shpresuar në shpërblimin e Allahut, i falen mëkatet e së kaluarës."

Ndër çështjet, dispozitat e të cilave mund të jenë të paqarta për disa njerëz, janë rastet kur agjëruetit i shkaktohet ndonjë plagë, i rrjedh gjak nga hundët, vjell ose i hyn në fyt ujë a diçka e lëngshme në mënyrë të pavullnetshme; të gjitha këto nuk e prishin agjërimin. Mirëpo, kush vjell qëllimisht, agjërimi i tij prishet, bazuar në fjalën e Profetit:

«مَنْ ذَرَعَهُ الْقَيْءُ فَلَا قِضَاءَ عَلَيْهِ، وَمَنْ اسْتَقَاءَ فَعَلَيْهِ الْقِضَاءُ».

"Kush vjell pa dashje, nuk detyrohet ta kompensojë agjërimin, ndërsa kush vjell me dashje, duhet ta kompensojë."

Prej këtyre rasteve është dhe vonesa e larjes nga xhunubllëku deri pas lindjes së agimit. Si dhe vonesa e larjes nga cikli menstrual apo lehonja deri pas lindjes së agimit për gruan që është pastruar para agimit. Në këtë rast ajo e ka për detyrë të agjërojë dhe nuk prish punë vonimi i larjes deri pas

lindjes së agimit. Megjithatë, nuk i lejohet ta vonojë atë deri sa të lindë dielli, por duhet të lahet dhe të falë namazin e sabahut para lindjes së diellit. Po kështu, burri apo femra që është xhunub nuk duhet ta vonojë guslin deri pas lindjes së diellit, por e ka për detyrë të lahet dhe ta falë namazin e sabahut para lindjes së diellit. Ndërsa burri e ka për detyrë të nxitojë, në mënyrë që ta arrijë namazin e sabahut me xhemat në xhami.

Prej çështjeve që nuk e prishin agjërimin, janë: analiza e gjakut dhe marrja e injeksioneve që nuk shërbejnë si ushqim, ndonëse shtyrja e tyre për natën është më parësore dhe më e sigurt nëse kjo është e mundur; për shkak të fjalës së Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!):

«دَعُ مَا يَرِيكَ إِلَى مَا لَا يَرِيكَ».

“Lëre atë që të ngjall dyshim dhe kapu pas asaj që nuk të ngjall dyshim!”

Si dhe hadithit të Profetit (paqja qoftë mbi të!):

«مَنْ اتَّقَى الشُّبُهَاتِ فَقَدْ اسْتَبْرَأَ لِدِينِهِ وَعِزِّهِ» [12].

“Kushdo që ruhet nga të dyshimtat, ka pastruar fenë dhe nderin e tij.” (12)

Prej çështjeve, dispozita e së cilës është e paqartë për disa njerëz, është mungesa e qetësisë në namaz, qoftë ai farz (i detyrueshëm) apo nafile (vullnetar). Hadithet e sakta nga i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) dëshmojnë se qetësia është një nga shtyllat e namazit, pa të cilën namazi nuk është

i saktë. Ajo nënkupton kryerjen e namazit me prehje të plotë, përkushtim dhe pa nxitim, derisa çdo rruazë e shtyllës kurrizore të kthehet në vendin e vet. Shumë njerëz e falin namazin e teravive në Ramazan në një mënyrë që as nuk e kuptojnë dhe as nuk kanë qetësi në të, por përkundrazi, lëvizjet e tyre janë si çukitjet e pulës kur ushqehet. Një namaz i falur në këtë mënyrë është i pavlefshëm, ndërsa falësi i tij është mëkatar dhe i pashpërblyer.

Prej çështjeve, dispozita e të cilave mund të jetë e paqartë për disa njerëz, është mendimi i disave se namazi i teravive nuk lejohet të pakësohet nën njëzet rekate, dhe mendimi i disa të tjerëve se nuk lejohet të shtohet mbi njëmbëdhjetë ose trembëdhjetë rekate. Të gjitha këto mendime janë hamendësime të padrejta dhe madje janë të gabuara sepse bien ndesh me argumentet.

Hadithet e sakta nga i Dërguari i Allahut (paqjaq oftë mbi të!) dëshmojnë se namazi i natës është fleksibël, kështu që nuk ka një kufi të caktuar që nuk lejohet të tejkalohet. Përkundrazi, është vërtetuar prej tij (paqja qoftë mbi të!) se ai falte gjatë natës njëmbëdhjetë rekate, e nganjëherë falte trembëdhjetë rekate, e nganjëherë edhe më pak se kaq, si në Ramazan, ashtu edhe jashtë tij. Dhe kur u pyet për namazin e natës, ai tha:

«مَثْنَى مَثْنَى، فَإِذَا خَشِيَ أَحَدُكُمْ الصُّبْحَ صَلَّى رَكْعَةً وَاحِدَةً تَوَيَّرَ لَهُ مَا قَدْ صَلَّى».

“Dy nga dy, e, nëse ndonjëri prej jush i frikësohet hyrjes së kohës së sabahut, le të falë një rekat, i cili ia bën tek namazin që ka falur!” Unanimisht i saktë.

Ai nuk ka caktuar numër specifik rekatesh, as në Ramazan e as jashtë tij. Për këtë arsye, sahabët në kohën e Umerit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) nganjëherë faleshin njëzet e tri rekate dhe herë të tjera njëmbëdhjetë rekate. E gjithë kjo është vërtetuar nga Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) dhe nga sahabët në kohën e tij.

Disa prej të parëve falnin në Ramazan tridhjetë e gjashtë rekate dhe e falnin vitrin me tre rekate, ndërsa disa të tjerë falnin dyzet e një rekate. Këtë e ka cituar Shejhul Islam Ibën Tejmije dhe dijetarë të tjerë. Po ashtu, ai (Allahu e mëshiroftë!) ka përmendur se çështja në këtë pikë është e gjerë, dhe gjithashtu ka përmendur se më e mira për atë që e zgjat këndimin, rukunë dhe sexhden është që ta pakësojë numrin e rekateve, ndërsa ai që i shkurton këndimin, rukunë dhe sexhden, e shton numrin e tyre.

Kushdo që mediton mbi Sunetin e Pejgamberit (paqja qoftë mbtë!), e kupton se më e mira në gjithë këtë është falja e njëmbëdhjetë ose trembëdhjetë rekateve, në Ramazan dhe jashtë tij; sepse kjo është në përputhje me praktikën e tij në shumicën e rasteve, si dhe është më e lehtë për namazfalësit dhe më afër përulësisë e qetësisë. Megjithatë kush

shton më shumë, nuk ka gjynah dhe as nuk është e papëlqyeshme, siç u përmend më parë.

Më e mira është që ai i cili falet me imamin në namazin e natës së Ramazanit, të mos largohet derisa të largohet edhe imami, bazuar në fjalën e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!):

«إِنَّ الرَّجُلَ إِذَا قَامَ مَعَ الْإِمَامِ حَتَّى يَنْصَرِفَ كَتَبَ اللَّهُ لَهُ قِيَامَ لَيْلَةٍ».

"Vërtet, kur njeriu qëndron me imamin derisa ai të përfundojë, Allahu i shkruan atij faljen e një nate."

Për të gjithë muslimanët është e ligjësuar që të angazhohen në lloje të ndryshme të adhurimit gjatë këtij muaji fisnik, si: namazi vullnetar, leximi i Kuranit me meditim dhe përsiatje, shtimi i tesbihut, tehlilit, tahmidit, tekbirit dhe istigfarit, bërja e lutjeve profetike, urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja, thirrja drejt Allahut, përkujdesja për të varfrit dhe nevojtarët, përkushtimi në mirësjellje ndaj prindërve, mbajtja e lidhjeve farefisnore, nderimi i fqinjit, vizita e të sëmurit, si dhe llojet e tjera të së mirës; bazuar në fjalën e Profetit (paqja qoftë mbi të!) në hadithin e mëparshëm:

«يَنْظُرُ اللَّهُ إِلَى تَنَافُسِكُمْ فِيهِ، فَيُبَاهِي بِكُمْ مَلَائِكَتَهُ؛ فَأَرَوْا اللَّهَ مِنْ أَنْفُسِكُمْ خَيْرًا، فَإِنَّ الشَّقِيَّ مَنْ حَرَمَ فِيهِ رَحْمَةَ اللَّهِ».

"Allahu e shikon garimin tuaj në të dhe krenohet me ju para melekëve të Tij; andaj, tregoni Allahut mirësi nga vetja juaj, sepse, me të vërtetë, i mjeri është ai që privohet në të nga mëshira e Allahut!"

Është transmetuar nga Profeti (paqja qoftë mbi të!) se ka thënë:

«مَنْ تَقَرَّبَ فِيهِ بِخُصْلَةٍ مِنْ خِصَالِ الْخَيْرِ كَانَ كَمَنْ أَدَّى فَرِيضَةً فِيمَا سِوَاهُ، وَمَنْ أَدَّى فِيهِ فَرِيضَةً كَانَ كَمَنْ أَدَّى سَبْعِينَ فَرِيضَةً فِيمَا سِوَاهُ».

"Kush kryen në të një vepër të mirë, është sikur të ketë kryer një farz jashtë tij, dhe kush kryen në të një farz, është sikur të ketë kryer shtatëdhjetë farze jashtë tij"

Dhe ka thënë gjithashtu në një hadith të saktë:

«عُمْرَةٌ فِي رَمَضَانَ تَعْدِلُ حَجَّةً، أَوْ قَالَ: حَجَّةٌ مَعِيَ».

"Një umre gjatë Ramazanit është e barabartë me një haxh, ose ka thënë: me një haxh me mua."

Hadithet dhe transmetimet që dëshmojnë për pëlqyeshmërisë e garimit dhe konkurrencës në lloje të ndryshme të veprave të mira gjatë këtij muaji fisnik, janë të shumta.

Allahut i lutemi të na japë sukses neve dhe mbarë muslimanëve për çdo gjë me të cilën Ai është i kënaqur, të na e pranojë agjërimin dhe namazin tonë të natës, ta përmirësojë gjendjen tonë dhe të na ruajë të gjithëve nga sprovat devijuese. Po ashtu, i lutemi Atij që t'i përmirësojë udhëheqësit e muslimanëve dhe t'ua bashkojë fjalën e tyre mbi të vërtetën. Padyshim Allahu është i Plotfuqishëm ta bëjë realitet një gjë të tillë.

Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ju!

Përmbajtja

DY BROSHURA TË SHKURTRA NË LIDHJE ME ZEKATIN DHE AGJËRIMIN	2
DY BROSHURA TË SHKURTRA NË LIDHJE ME ZEKATIN DHE AGJËRIMIN	2
Broshura e parë:	2
HULUMTIME TË RËNDËSISHME QË KANË TË BËJNË ME ZEKATIN.....	2
Broshura e dytë:	13
VLERA E AGJËRIMIT TË RAMAZANIT DHE NAMAZIT TË NATËS, ME SQARIMIN E DISPOZITAVE TË RËNDËSISHME QË MUND TË JENË TË PANJOHURA PËR DISA NJERËZ	13